



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ALBANIAN SEAPORTS DEVELOPMENT COMPANY SH.A

Datë 11/04/2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: MIRËMBAJTJE E OBJEKTIT “ZYRAT MODULARE PËR
AGJENCITË DOGANORE”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

98341110-9 (Shërbime mirëmbajtjeje); 50000000-5 (Shërbime mirëmbajtje dhe riparimi);
98341130-5 (Shërbime pastrimi); 90450000-6 (Shërbime të trajtimit të gropave septike);
77310000-6 (Mbjellja dhe shërbimet e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbra) etj.

VLERA E FONDIT LIMIT: 9,966,250 (nëntë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë
e dyqind e pesëdhjetë) lekë për një vit pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
e ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor “**Albanian Seaports Development Company**” sh.a ka
hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 të DST;
- b. Formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nenin 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 26 dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e kësaj kontrate, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, për kategoritë e mëposhtme:

- **II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjeno-shëndetësore” (dezinfektim)**
- **III.2.B “Për transportim, grumbullim, mbetjeve jo të rrezikshme”** me kode të mbetjeve sipas katalogut shqiptar të mbetjeve (20 01 01, 20 01 02, 20 01 08, 20 01 39, 20 01 99, 20 02, 20 03, 20 03 01, 20 03 04, 20 03 06, 20 03 99).
- **Leje Mjedisit me kod III.1.B** me ID “Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontenjerët ose nga larjet e kontenjerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, licencat profesionale duhet ti paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër shërbimet për të cilat kërkohet licenca profesionale, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar ; Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 ”Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe në përmbushje të detyrimeve ligjore që përcakton Ligji nr. 10431 datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (të ndryshuar), Ligji nr. 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, me Ligjin 52/2020 Shtoiça 1 “Menaxhimi i Mbetjeve , ID 5.9 (Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.), Ligji nr. 10463 , datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e Integruar të Mbetjeve“ i ndryshuar nenet 21, 57,58,59 si dhe Ligji nr. 10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat Autorizimet dhe Lejet në Republikën e

Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 ”Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, me kode të mbetjeve sipas katalogut shqiptar të mbetjeve.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në preventivin dhe zërat e shërbimeve që Autoriteti Kontraktor do të kryejë për mirëmbajtjen e objektit ”Zyrat modulare për agjencitë doganore”.

Më konkretisht, nevojitet licenca për Kategorië II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjenshëndetësore” (dezinfektim), pasi A.K ka parashikuar si shërbim edhe kryerjen e dezinfektimit të godinës brenda dhe jashtë saj 2 (dy) herë në vit, si një shërbim i rëndësishëm për sigurinë dhe shëndetin publik. Dezinfektimi është një pjesë e rëndësishme e pastërtisë dhe sigurisë së ambienteve publike. Licenca e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, siguron se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar për të kryer këtë detyrë me kujdes dhe profesionalizëm.

Për të kryer dezinfektimin me efikasitet, është e rëndësishme që operatori ekonomik ofertues të ketë njohuri dhe trajnime profesionale në lidhje me metodat dhe substancat e përdorura për dezinfektimin. Një licensë nga një autoritet i licensimit e bën operatorin ekonomik ofertues përgjegjës para ligjit për veprimtarinë e tij. Kjo siguron se operatori ekonomik do të respektojë standardet dhe udhëzimet e ofruara nga autoriteti i licensimit dhe do të përballojë çdo shkelje të këtyre standardeve në mënyrë të rregullt.

Gjithashtu, nevojitet licenca për Kategorinë III.2.B “Për transportim, grumbullim, të mbetjeve urbane dhe ujrave të zeza”, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit, pasi A.K duhet të sigurohet që Operatori Ekonomik do të jetë i specializuar dhe licensuar për kryerjen e operacioneve të sigurta të pastrimit, grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve të gjeneruara dhe ujrave të zeza (duke qënë se në këtë procedurë prokurimi është parashikuar shërbimi i pastrimit në tërësi të godinës duke përfshirë dhë grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve urbane si edhe pastrimin e gropës septike) deri në destinacionin përfundimtar të tyre.

Operatori duhet të jetë i pajisur me lejen përkatëse mjedisore për të kryer veprimtarinë e pastrimit dhe evadimin të mbetjeve nga një territor Portual.

Kriteret për licensat e lëshuar nga QKL janë vendosur që A.K të ketë sigurinë që Operatori Ekonomik që do të ofertojë zotëron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

2.1.2 Operatori ekonomik që do të realizojë këtë kontratë, për të vërtetuar se shërbimet objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatëse të vlefshme të ISO (të përkthyer në shqip dhe të noterizuara) të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Certifikatat përkatëse ISO janë:

- Çertifikatë ISO 9001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit;
- Çertifikatë ISO 14001:2015, të standartit ndërkombëtar të menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit;
- Çertifikatë ISO 45001:2018 të standartit ndërkombëtar të Sistemi të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente me të që mund të garantojë cilësinë e shërbimeve të kërkuara, objekt i tenderit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes paraprake të bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Referuar kësaj baze ligjore, Autoriteti Kontraktor, ka të drejtë të kërkojë certifikata të lëshuara nga një organ i akredituar ose organizma ndërkombëtarë, me qëllim që, operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën, të jenë certifikuar në sistemet e menaxhimit të cilësisë, të mjedisit, të shëndetit dhe sigurisë në punë si dhe menaxhimit të integruar, në përputhje me objektin e kësaj kontrate dhe e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilën AK kërkon ta kryejë me cilësi dhe në kohë.

Duke parë objektin e prokurimit, preventivin dhe vlerën e saj, autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij që të kërkojë certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, që përpos shërbimeve që do të kryhen nga operatorët ekonomik ofertues, këto shërbime të kryhen me cilësi sipas certifikatave ISO të mësipërme.

• **Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015** është përcaktuar si kriter nga AK për arsye se përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.

Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit të OE ofertues dhe që ky i fundit do të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

• **Certifikata e menaxhimit të cilësisë së mjedisit ISO 14001:2015.** Ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit mjedisor, me anë të së cilës garantohej mundësitë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një subjekti me synim parandalimin e dëmtimit të mjedisit, respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me mjedisin dhe ruajtjen e burimeve natyrore.

Ky kriter është kërkuar nga AK për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të mjedisit dhe garanton se është i certifikuar për produkte të cilat nuk dëmtojnë mjedisin dhe nuk e ndotin atë dhe që janë konform standardeve ndërkombëtare të cilësisë. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

Kërkesa për certifikatën ISO 14001 është kërkuar duke pasur parasysh natyrën dhe përmasat e kontratës. Kemi të bëjmë me mallra lidhur kryesisht me shërbimin e pastrimit, të cilat kanë në përbërje substanca të cilat kanë ndikim në mjedis dhe Sistemi i Menaxhimit Mjedor ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale.

• **Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001: 2018.** Kjo ISO ka për qëllim të jetë e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj. Ky kriter është përcaktuar nga AK për të krijuar bindje se operatori ekonomik ofertues përmbush standartet e kërkuara në mbrojtje të shëndetit dhe sigurisë në punë. Ky lloj standarti konsiston në sigurimin e një sistemi shëndetësor optimal dhe menaxhimin e sigurisë në punë.

AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare **2021, 2022, 2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se Operatori Ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara 2021, 2022, 2023 për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik dhe të mundësisë së tij për përmbushjen me sukses të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik në fuqi dhe në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që operatori ekonomik para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

Autoriteti Kontraktor duke u bazuar në rëndësinë e objektit të prokurimit për mbarëvajtjen e punës si dhe hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare; si dhe Ligjin Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar dhe Udhëzimin e përgjithshëm Nr. 26, datë 08.09.2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, VKM Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm*

nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021, 2022, 2023** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të konfirmuara nga këto autoritete. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar , atëherë bilancet duhet të jenë të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë **jo më pak se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 2, 3, neni 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e

mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar .

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik në fuqi, duke marrë në konsideratë edhe vlerën e përlogaritur të kontratës që prokurohet.

Ky kriter i shërben AK për të provuar besueshmërinë mbi përvojën e Operatorit Ekonomik ofertues në treg dhe për të treguar se OE me kapacitetet e tij ka realizuar kontrata të ngjashme me objektin që po prokurohet në afat dhe me cilësi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton Autoritetin Kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie, në përputhje me përcaktimet e DST.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 8 (tetë) punonjës të specializuar/ të kualifikuar, në profilet sipas tabelës së mëposhtme:

Stafi	Nr.
Përgjegjës për mirëmbajtjen	1 (një)
Punonjës elektrikist	1 (një)
Punonjës hidraulik	1 (një)
Punonjës shërbimi/Sanitar	3 (tre)
Lulishtar/Kopështar	1 (një)
Punonjës dezinfektimi, për operimin e pajisjeve dezinfektuese dhe/ose preparateve	1 (një)
Totali i punonjësve	8 (tetë)

Për punonjësit me profesionet e mësipërme, OE duhet të paraqesë:

Për përgjegjës për mirëmbajtjen të paraqitet:

- Diplomë (shkollë e mesme elektrike/mekanike/hidraulike) ose Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontratë individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse si mirëmbajtës.

Për punonjës elektrikist të paraqitet:

- Diplomë (shkolle e mesme elektrike) ose Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontrate individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës ;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.

Për punonjësin hidraulik të paraqitet:

- Diplomë (shkolle e mesme hidraulike) ose Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontrate individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës ;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.

Për punonjësit e shërbimit/sanitar të paraqitet:

- Kontrate individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse;

Për punonjësin Lulishtar/Kopshtar të paraqitet:

- Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontrate individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.

Për punonjësin e Dezinfektimit të paraqitet:

- Çertifikatë të vlefshme që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional në R.Sh apo dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me të.
- Kontrate individuale pune të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës;
- Librezë pune, CV ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën përkatëse.

- **Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtëm:**
-

Nr.	Emër Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
-----	--------------	------------	---

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Shënim: Me qëllim garantimin e gjithë përfshirjes, për ti dhënë mundësi çdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do t’i paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim: Stafi i përcaktuar në tabelën e mësipërme të cilët do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor, për zbatimin e kësaj kontrate, nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera, deri në përfundim të kontratës objekt prokurimi. Për këtë arsye të paraqitet Deklaratë përkatëse nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/a,b, c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me zërat e parashikuar në preventivin e AK duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimeve që do të realizohen si dhe kohëzgjatjen e tyre.

Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto shërbime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre shërbimeve sipas standarteve të kërkuara.

Ky numër punonjësish vlerësohet minimal për të garantuar zbatimin si dhe mirëmbajtjen e suksesshme të objektit "Zyrat modulare për agjencitë doganore".

Më konkretisht argumentojmë se është e nevojshme prezenca e punonjësve të lartpërmendur pasi:

-Përgjegjësi i mirëmbajtjes, do të koordinojë dhe mbikëqyrë punën e të gjithë punonjësve të tjerë përkatës dhe do të jetë përgjegjës për menaxhimin e të gjitha hallkave dhe proceseve lidhur me të gjitha shërbimet hidraulike,elektrike, të pastrimit, mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbra, që do të nevojiten të kryhen për mirëmbajtjen në tërësi të godinës për 12 muaj/1 vit ;

Përgjegjësi i mirëmbajtjes do të jetë gjithashtu pikë kontakti midis Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor. Ky punonjës do të jetë në dispozicion të A.K për çdo kërkesë apo problematikë që mund të lindë në të ardhmen gjatë zbatimit të kontratës. Ky punonjës do të jetë gjithmonë disponibël dhe do t'i përgjigjet të gjitha kërkesave të A.K për zgjidhjen e problemeve që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës dhe do të kujdeset për mirëmbajtjen në tërësi të hapësirës së brendshme dhe të jashtme të godinës;

-Punonjësi elektrikist, i cili do të garantojë mirëmbajtjen e rrjetit elektrik të godinës, aparateve dhe pajisjeve të tjera dhe do të marrë përsipër ndreqjen e defekteve në mosfunksionimin e sistemeve elektrike dhe komponentëve të tyre që mund të lindin në të ardhmen.

-Punonjësi hidraulik, i cili do të garantojë mirëmbajtjen e rrjetit hidrik dhe do të marrë përsipër ndreqjen e defekteve në mosfunksionimin e instalimeve hidraulike dhe pajisjeve hidraulike që mund të lindin në të ardhmen;

-Punonjësit e shërbimit sanitar, të cilat do të marrin përsipër pastrimin e ambienteve të brendshme (zyra, korridore, tualete, shkallë) dhe të jashtme (sheshet dhe parkingun përreth godinës). Duke qënë se Godina është 3-katëshe A.K ka parë të arsyeshme të kërkojë tre punonjës të shërbimit sanitar, nga një për secilin kat.

-Punonjësi lulishtar/kopshtar, i cili do të merret me mbjelljen e luleve dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta në ambientet e jashtme përreth godinës.

-Punonjësi i dezinfektimit, i cili do të jetë përgjegjës për operimin e preparateve dhe pajisjeve dezinfektuese për dezinfektimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të godinës.

Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast, rezulton në realizimin jashtë afatit të kryerjes së shërbimit dhe me cilësi të dobët të kryerjes së tyre.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 5 (pesë) persona.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik i kualifikuar në çdo rast përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë dokumentet provuese si:

- a. Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Listëpagesat e punonjësve të deklaruar në organet tatimore sipas formularit E-Sig 025/a, për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në lidhje me vërtetimin të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve kjo kërkesë është e mbështetur gjithashtu në nenin 41, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruar me listëpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

Në lidhje me numrin e fuqisë punëtore të siguruar, duke patur parasysh volumet e shërbimeve objekt kontrate, natyrën, vlerën e kontratës, dhe kohëzgjatjen e saj, ky numër punonjësish është proporcional dhe i lidhur me aftësinë zbatuese, me qëllim realizimin në kohë dhe me sukses të kontratës.

Pra vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas projektit si dhe shërbimet do të kryhen brenda afatit kohor.

Numri total i personelit të kërkuar, është bërë për të garantuar që operatori ekonomik ka strukturën organizative, eksperiencën si dhe organizimin e duhur (edhe në rast të mungesës së përkohshme për arsye objektive të një apo më shumë punonjësve) për të marrë përsipër një ndërmarrje të tillë.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Në bazë të llogaritjeve të zërave të shërbimeve dhe volumit përkatës të punës të çdo zëri në preventiv si dhe grafikut të zbatimit të shërbimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda afateve të përcaktuara, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet e mëposhtme:

Përshkrimi i mjetit	Njësia	Sasia	Statusi
Mjet teknologjik për transportimin e mbetjeve urbane	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje
Automjet teknologjik/Autobot me thithje për pastrimin e gropës septike	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje
Autobot uji për furnizimin me ujë të godinës dhe/ose për vaditje	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje

Për mjetet e mësipërme, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

• Kur mjeti shënohet në regjistra publikë dhe është në pronësi, duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit në emër të shoqërisë (leje qarkullimi);
- çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- d) foto të mjetit ku të duken qartë targa dhe karakteristikat e tjera të mjetit;

• Kur mjeti regjistrohet në regjistra publikë por nuk është në pronësi të ofertuesit duhet të paraqitet:

- kontrata e qirasë/huapërdorjes e lidhur para noterit, me afat për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi, e shoqëruar me dokumentacion që vërteton pronësinë e qiradhënësit/huadhënësit;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);

- c) çertifikata e vlefshme e kontrollit teknik (SGS);
- ç) siguracioni (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;
- d) foto të mjetit ku të duken qartë targa dhe karakteristikat e tjera të mjetit;

• Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo ç’doganimit, fotot dhe fatura tatimore përkatëse, ndërsa për mjete të marra me qira/huapërdorje, krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë/huapërdorjes.

Shënim: Ky kriter (2.3.4) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: Dokumentacioni provues i lartpërmendur do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë ofertuese/Drejtuuesi Ligjor i shoqërisë, se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi dhe se këto mjete nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Gjithashtu në këtë deklaratë të deklarohet edhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga A.K, pasi ky i fundit rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e deklaruar sipas shtojcës 9 të DST-së.

Mjetet që do të deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qënë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për s’kualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën, për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë llojin dhe numrin e pajisjeve/makinerve të mëposhtme:

Nr.	Përshkrimi i pajisjeve	Njësia	Sasia	Statusi
1.	Platformë ngritëse për pastrime në lartësi	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje
2.	Pompë profesionale dezinfektimi	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje
3.	Makinë korrëse bari	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje
4.	Sondë teknologjike me pompë vakumi dhe presioni	copë	1 (një)	Në pronësi/qira/huapërdorje

- Për makineritë/pajisjet në pronësi, nga operatori ekonomik ofertues të vihen në dispozicion faturat tatimore të blerjes/faturat e zhdoganimit/kontratë blerje në emër të shoqërisë dhe foto të pajisjeve/makinerive.

- Për makineritë/pajisjet me qira të paraqitet kontrata noteriale e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi e shoqëruar me dokumentacionin që vërteton pronësinë e qiradhënësit (fatura tatimore/zhdoganim/kontratë blerje) dhe foto të pajisjeve/makinerive.

• Për të provuar disponimin e pajisjeve/makinerive profesionale me parametrat e kërkuar, Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogët/skedë teknike për makineritë profesionale, ku të pasqyrohen qartë të dhënat e kërkuara në specifikimet teknike.

Shënim: Ky kriter (2.3.5) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST, siç parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Shënim: Dokumentacioni provues i lartpërmendur do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Shënim: Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim nga Administratori i shoqërisë ofertuese/Drejtuesi Ligjor i shoqërisë, se pajisjet/makineritë profesionale të paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi dhe se këto pajisje/makineri nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. Gjithashtu në këtë deklaratë të deklarohet edhe vendndodhja e pajisjeve/makinerive në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga A.K, pasi ky i fundit rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës pajisjet/makineritë e deklaruar sipas shtojcës 9 të DST-së.

Pajisjet/makineritë profesionale që do të deklarohen, detyrimisht do të paraqiten Autoritetit Kontraktor për të qënë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Rastet e deklaratave të rreme, do të konsiderohen kushte për s'kualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion makineritë/pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se pajisjet/pjesët e këmbimit elektrike dhe hidraulike që do të duhet të ndërrohen, duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për s'kualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me pikën 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar.

2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se materialet e pastrimit, hidraulike dhe elektrike që ai do të furnizojë, do të jenë sipas kërkesave teknike të përcaktuara në specifikimet teknike.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” citohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se, produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, janë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me kapacitetin dhe sasi të përkatëse që do të përdoren për shërbimin e kërkuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” citohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë në gjuhën shqipe, origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentet e paraqitura në gjuhë të tjera nga shqipja duhet të shoqërohen me përkthimin e certifikuar në gjuhën shqipe;

Dokumentet e lëshuara nga autoritete publike në juridiksione të tjera, dhe dokumentet e vërtetuara nga një noter publik në juridiksione të tjera duhet të legalizohen sipas Konventës së Hagës për Vulën Apostile, të datës 05.10.1961;

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s’kualifikim.

NJËSIA E PROKURIMIT